

TOYOTA RELAX

Kushtet e Garancisë së Zgjatur Toyota Relax

Garancia e zgjatur Toyota Relax aktivizohet pasi të keni kryer shërbimet e automjetit tuaj në një Servis të Autorizuar Toyota, e vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë, Republikës së Bullgarisë, ose Republikës së Maqedonisë Veriore.

Vlefshmëria e tij, është 1 vit, ose 15.000 km ; 1 vit, ose 20.000 km ; 1 vit, ose 30.000 km ; 2 vjet, ose 40.000 km; 2 vjet, ose 50.000 km, cilado që të vijë e para, në varësi të kushteve për mirëmbajtje periodike të specifikuara në Librin e Garancisë të automjetit tuaj.

Garancia e zgjatur Toyota Relax do të zbatohet në rast se kërkohet ndërhyrje për të riparuar një dëmtim elektronik, ose mekanik të automjetit tuaj për shkak të një defekti prodhimi, ose instalimi nën kushtet e përshkruara në këtë dokument.

Servisi i Autorizuar Toyota nga i cili u ble Garancia e Zgjatur Toyota Relax, do të jetë kontakti juaj për çdo pyetje në lidhje me termat dhe kushtet e përdorimit të Garancisë së Zgjatur Toyota Relax.

Nëse nuk jeni në gjendje të kontaktoni Servisin tuaj të Autorizuar Toyota, në rast të defektit të automjetit tuaj, ju mund të kontaktoni ndonjë Servis tjetër të Autorizuar Toyota të zgjedhur nga ju në vendet e renditura, si më poshtë:

Zona gjeografike

Shqipëri, Austri, Andorra, Belgjikë, Bosnje Hercegovina, Bullgaria, Britania e Madhe, Gjermania, Gjibraltari, Greqia, Danimarka, Estonia, Izraeli, Irlanda, Islanda, Spanja, Italia, Ishujt Kanarie, Qipro, Kosova, Letonia, Lituania, Lihtenshtajni, Luksemburgu, Maqedonia e Veriut, Malta, Monako, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Rumania, Rusia, Republika Sllovake, Sllovenia, Serbia, Turqia, Finlanda, Franca, Hollanda, Kroacia, Mali i Zi, Republika Çeke, Zvicra, Suedia, Ukraina dhe Hungaria.

1. Garancia e zgjatur Toyota Relax, fillimi dhe kohëzgjatja e garancisë së zgjatur, shtrirja dhe automjetet e përjashtuara.

Pronarët e automjeteve Toyota mund të përfitojnë nga disa zgjatje radhazi të garancisë, pasi zgjatja e garancisë rinovohet gjatë çdo mirëmbajtjeje periodike dhe është e vlefshme për 1 vit, ose 15.000 km; 1 vit, ose 20.000 km; 1 vit, ose 30.000 km; 2 vjet, ose 40.000 km; 2 vjet, ose 50.000 km, cilado që të vijë e para, në varësi të kushteve të garancisë së automjetit tuaj, me kusht, që kriteret e pranimit të përmbushen, si më poshtë:

Garancia e zgjatur Toyota Relax është e vlefshme vetëm për automjete që plotësojnë plotësisht kërkesat e detajuara në vijim:

a. Garancia e prodhuesit, ose garancia Extracare, është në një nga situatat e mëposhtme:

a.1 Ka skaduar;

a.2 Do të skadojë para periudhës tjetër për mirëmbajtje periodike të specifikuar në Librin e Garancisë së automjetit tuaj (1 vit, ose 15.000 km; 1 vit, ose 20.000 km; 1 vit, ose 30.000 km; 2 vjet, ose 40.000 km; 2 vjet, ose 50.000 km, cilado që të vijë e para.

b. Automjeti është më pak se 10 vjet, nga data në të cilën automjeti u vu për herë të parë në shërbim;

c. Automjeti ka një kilometrazh total prej më pak se 185.000 km;

d. Mos i përkasë asnjë prej kategorive të mëposhtme të automjeteve:

d.1 automjetet e përdorura në gara, ose autoskollë;

d.2 automjetet e policisë, zjarrfikëse, ambulancat dhe automjetet e përdorura nga shërbimet e tjera të urgjencës;

d.3 automjete me defekte teknike të pjesëve të ndryshme nga ato që mund të rregullohen sipas kushteve të këtij programi;

d.4 automjetet me qira në një grup / organizatë;

- e) Nëse mbulimi i Garancisë së Zgjatur Toyota Relax, Garancisë së Prodhuesit, ose Garancia Extra Care, ka skaduar, defekti ndodhi brenda tridhjetë (30) ditëve të para pas mirëmbajtjes periodike dhe nisjes së një Garancie të Zgjatur Toyota Relax, si dhe ato që tashmë ekzistojnë në datën e vizitës në shërbimin e mirëmbajtjes periodike, nuk do të mbulojnë nga Garancia e Zgjatur Toyota Relax.
- f) Gabimet DTC (kodi i problemeve diagnostikuese) të automjetit nuk janë fshirë brenda tridhjetë (30) ditësh, ose një mijë e pesëqind (1.500) kilometra para se automjeti të diagnostikohet nga një Servis i Autorizuar Toyota për shërbimin periodik dhe marrjen e Garancisë së Zgjatur Toyota Relax.

2.Mbulimi Toyota Relax

Pronari i makinës, sipas Garancisë së Zgjatur Toyota Relax, ka të drejtë të marrë riparime falas në çdo servis të Autorizuar Toyota që ndodhet në Republikën e Shqipërisë, Republikën e Bullgarisë dhe Republikën e Maqedonisë Veriore, subjekt i kushteve dhe përjashtimeve të specifikuar në kushtet aktuale të Toyota Relax të pjesëve më poshtë:

Motori: Bllok cilindri i motorit, Bosht balancues, Bosht me gunga, Valvola, Udhëzues dhe kushineta, Kokat e cilindrit, Guarnicione të cilindrit, Elementë të boshtit motorik, Volant, Ingranazhi i volantit për motorino, Rul parazitar, Sotokarter, Sensori i presionit të vajit të motorit, Pompë vaji, Pistonat, Bronxina dhe Fasho, Guarnicione, Rrip faze, Tensionues i rripit, Rul parazitar, Ingranazh dhe zinxhir, Turbinë, Radiator intercooler, Valvol turbine, Kapak i testatës, Pompë uji, Egr, Ftohës vaji, Bazament i filtrit të vajit, Sensori i oksigjenit.

Sistemi i benzinës: Pompë elektrike e karburantit, Matës i rrjedhës së ajrit, Sistemi elektronik i injektimit të karburantit, Njësia e kontrollit elektronik (ECU), Farfallë, Injektorë, Rregullatori i presionit të karburantit, Galixhant i karburantit, Sensorë të karburantit, Rezervuar karburanti, Treguesi i karburantit.

Sistemi diesel: Pompë injeksioni karburanti, Pompë e karburantit, Matës i rrjedhës së ajrit, Njësia e kontrollit elektronik (ECU), Sensori i pozicionit të gazit, Injektorë karburanti, Kandeleta për ndezjen në të ftohtë, Sensori i nivelit të karburantit, Rezervuar karburanti.

Sistemi i ftohjes: Sensori i nivelit të ftohësit, Rele e kontrollit të ventilatorit ftohës, Sensori i ventilatorit të ftohjes, Sensori i temperaturës së ftohësit të motorit, Ventilator, Radiator, Termostati.

Kambio manuale: Pompë pedal friksioni, Pompë freksioni, Furçellë, Kavo, Tub alkooli, Kutia e transmisionit, Ingranazhe dhe boshte, Sinkronizues, Kushineta, Guarnicione, Leva.

Kambio automatike: Kutia e transmisionit, Ingranazhe, Leva e kambios, Aktuatorë elektronikë, Konektorë, Bllok valvulash, Pompë vaji, Ftohës vaji, Njësia e kontrollit elektronik, Kushineta dhe suportet, Guarnicione, Kavo.

Diferenciali: Diferencial qëndror, Kutia e diferencialit, Koronë dhe pinjon, Bosht, Ingranazhe, Kushineta, Gomina.

Transmisioni: Nyje lëvizëse, Bosht Kardanik, Gomina (mbulimi deri në 160,000 km), Semiakse, Kushineta; Guarnicione.

Suspensionit: Sustat e përparme dhe të pasme, Stabilizatorë, Koka stabilizatorësh, Bazament moco, Urë, Kushinetë moco (mbulimi deri në 160,000 km), Moco, Bullona, Dado.

Sistemi i drejtimit: Njësi hidraulike e timonit, Kuti e timonit, Kremalieri, Pompë hidraulike, Rezervuar hidraulik i lëngjeve, Kushineta, Koke paraleli, Krahë paraleli, Aks Timoni, Krah timoni.

Sistemi i frenimit: Njësia ABS, Përbërësit e ABS, Sensorë të shpejtësisë së rrotave, Depresori, Tuba frenash, Pipeta të frenave, Valvola rregulluese, Cilindër kryesor, Rezervuari i lëngut të frenave, Cilindra nofull freni, Pompë vakumi.

Kondicioneri Ftohja/Ngrohja: Radiator, Farfallë ajri dhe motorë, Motori i ventilatorit të ngrohjes, Kompresor AC, Radiator AC, Serpentinë e brendshme ftohëse, Serpentinë e brendshme ngrohëse, Paneli i kondicionerit, Valvula e ngrohjes, Sensori i temperaturës së avulluesit.

Sistemi elektrik: Motorrino, Dinamo, Bobinë, Motor fshirëse, Pompë larëse xhami, Rele sinjalesh, Kompjuter i bordit, Çelësa që operohen manualisht, Kabëll spiral, Njësia e ndezjes elektronike, Elementë ngrohëse të xhamit, Kroskoti, Krik xhami, Çelësa elektrik të dritareve, Motorë të kontrollit të pasqyrave, Pulti, Bravat e mbylljes qëndrore, Sensorë të airbageve, Njësia e kontrollit të mbylljes qëndrore, Njësia e kontrollit të ndriçimit të brendshëm, Ora, Sensor i shpejtësisë, Takometër, të gjitha instalimet elektrike (vetëm për qark të shkurtër), Motorë elektrik të sediljeve, Ndezës cigare,

Sensorë, Ngrohje sediljesh, Alarme (vetëm origjinale Toyota), Kabllot e kandleve, Paketa e motorit dhe programi (përveç kur është fshirë gabimi DTC).

Kabina: Tavan panoramik (vetëm origjinal Toyota), Motorë tavani panoramik (vetëm origjinal Toyota), Brava, Mentasha Kofano, Amortizatorë derë bagazhi, Mekanizëm i fshirëseve, Shina e sediljeve, Mekanizmi i rripit të sigurimit, Aksesorë të instaluar në fabrikë, dhe aksesorët e instaluar shtesë, që janë deklaruar nga NMSC në CWS brenda tre muajve pas regjistrimit të parë të automjetit.

Komponentët hibridë (pas 5 vitesh dhe 100,000 km mbulim i garancisë bazë): Moduli i menaxhimit të baterisë hibride, Moduli i kontrollit hibrid dhe inverter me konverter.

Komponentët e qelizave të karburantit hidrogjen: Kompresor ajri i qelizave të karburantit, Konverter / amplifikator i qelizave të karburantit, Depozitat e qelizave të karburantit H2, PCU (Power Control Unit) me qelizë djegëse (njësia e kontrollit të karburantit) dhe paketa e qelizave të karburantit.

Komponentët EV: Motor elektrik dhe inverter me konverter.

Mbulimi i Garancisë së Zgjatur Toyota Relax përfshin riparime falas, duke përfshirë fuqinë punëtore falas dhe pjesë këmbimi nga rrjeti i autorizuar Toyota në territorin e Republikës së Shqipërisë, Republikës së Bullgarisë dhe Republikës së Maqedonisë Veriore.

Pjesët mund të riparohen, ose zëvendësohen sipas gjykimit të Servisit të Autorizuar Toyota që kryen procedurën.

Riparimet mund të kryhen nga cilido Servis i Autorizuar Toyota në vendet e renditura në zonën gjeografike të lart përmendur.

Nëse riparimi kryhet jashtë rrjetit të autorizuar Toyota, ai nuk do të mbulohet nga Toyota Relax.

Çmimi i çdo riparimi sipas kushteve të Toyota Relax nuk mund të kalojë vlerën e vet automjetit.

Shuma e kostove (përfshirë T.V.SH.-në) e të gjitha riparimeve dhe shërbimeve gjatë periudhës së aplikimit të Garancisë së Zgjatur Toyota Relax nuk mund të kalojë çmimin e blerjes së Automjetit.

Nëse shuma e shërbimeve tejkalon vlerën e automjetit, klienti do të paguajë diferencën në kosto.

Pjesët e zëvendësuara do të bëhen pronë e Shoqërisë Alto Sh.p.k. – Toyota Albania.

3. Toyota Relax

Garancia e zgjatur Toyota Relax, nuk do të mbulojë kostot e riparimit në rastet e mëposhtme:

- pjesa nuk është përmendur qartë në listën e pjesëve të mbuluara në pikën 2 më lart;
- është rezultat i konsumit normal, xhokove normale, zhurmave, ose vibrime normale;
- automjeti nuk është pastruar, mirëmbajtur dhe/ose riparuar në përputhje me rekomandimet e prodhuesit;

Kjo është një kërkesë që është e vlefshme që nga data e regjistrimit të parë të automjetit. Në lidhje me këtë, pronari duhet të jetë në gjendje të demonstrojë, nëse është e nevojshme, se çdo shërbim është kryer me pjesë origjinale.

- është rezultat i defekteve, të cilat nuk janë raportuar menjëherë te një Servis i Autorizuar Toyota, ose Servisit të Autorizuar Toyota nuk i është dhënë mundësia për të kryer riparime;
- është rezultat i riparimeve që nuk janë kryer nga një Servis i Autorizuar Toyota;
- është rezultat i defekteve që rezultojnë nga përdorimi i automjetit jashtë rekomandimeve të prodhuesit (p.sh. abuzimi, gara ekstreme jashtë rrugës, modifikimi, ngarkim i tepërt, etj.);
- është rezultat i defekteve që vijnë nga një shkak i jashtëm dhe/ose fenomen natyror (p.sh. depërtimi i ujit, ose pluhurit, gurët e grimcuar, përmbytjet, ngrirja, stuhitë, katastrofat natyrore, aksidentet, zjarri, shpërthimet, lufta, trazirat civile, armiqësitë, qëllimisht, ose veprim keqdashës, përdorim i pa autorizuar, kripë, erozion dhe gërvishtje në xham, ndotje);
- është rezultat i defekteve jo përgjegjësi nga Toyota;
- është rezultat i dëmtimit të shkaktuar nga aksesorët, ose pajisjet speciale, të cilat nuk janë origjinale Toyota;
- është rezultat i defekteve të shkaktuara nga sjellja e gabuar me dashje, ose nga pakujdesia (duke përfshirë, lubrifikantë dhe lëndë djegëse të papërshtatshme);
- është për shkak të modifikimeve në modelin origjinal të automjetit, ose instalimit të disa aksesorëve dhe/ose pajisjeve, si rezultat i të cilave automjeti nuk plotëson standardet minimale të përcaktuara nga prodhuesi;

- automjeti është i pajisur me pjesë që nuk korrespondojnë me cilësinë e pjesëve origjinale të prodhuesit.
 - është rezultat i gomave të montuara gabimisht, riparimit të pasaktë, ose zëvendësim i gabuar;
 - është pasojë e instalimit të pasaktë;
 - është shkaktuar nga përdorimi i një pjese që në mënyrë të identifikueshme kërkon riparim, përveç, nëse mund të demonstrohet se dëmi nuk ka të bëjë me pjesën specifike që ka nevojë për riparim.
- Toyota Relax nuk do të mbulojë kostot e:
- çdo kosto indirekte, p.sh. fitimet, ose të ardhurat e humbura për pronarin e automjetit, transporti, tërheqje, telefonatat, akomodimi, qira, humbja e ndonjë pasurie, ose sendi me vlerë.
 - elementë estetike p.sh. riparimi bojës, riparimi i ndryshkut, njollat, venitjet, deformimi, dëmtimi nga hyrja dhe kondensimi i ujit;
 - kërkesa për dëmshpërbim kur ka prova të pa sakta të dëmtimit, mosveprimit, ose fshehjes së të dhënave në lidhje me pretendimet;
 - dëmtimi dhe pasojat për të cilat Toyota nuk është përgjegjëse;
 - dëmtimi i qëllimshëm, ose nga pakujdesia, duke përfshirë, përdorimin e lubrifikantëve, apo karburantit jo të përshtatshëm;
 - dëmtimi që rezulton nga një ndryshim në konstruksionin origjinal / çertifikata e konformitetit të automjetit /, ose instalimin e pajisjeve shtesë, që do të thotë se automjeti nuk i plotëson më specifikimet e prodhuesit dhe pasojat e këtyre ndryshimeve;
 - pasojat e riparimeve të mëparshme, zëvendësimi, ose vendosja e pjesëve jo të përshtatshme;
 - mosfunksionim i çfarëdo lloji, që ndodh pas ndryshimit të kilometrave origjinale në kroskot;
 - defektet e shkaktuara nga ruajtja e pa përshtatshme e automjetit;
- Pjesët dhe komponentët e mëposhtëm përjashtohen nga mbulimi Toyota Relax:
- Pjesët e mirëmbajtjes (p.sh. pjesët që do të zëvendësohen periodikisht, filtrat, ferrotat dhe disqet, fresksioni, spinxhidisku dhe kushineta, disqet, goma, rrip dinamo, bateri (me përjashtim të baterisë hibride, përveç, nëse thuhet qartë se janë të mbuluara), lëngje, kandle, diagnostifikimi;
 - Pjesë gome (p.sh. tub gome, tuba, këmbë motori, ose kabine, shirita, fshirëse xhami), gominë semiaksi, amortizues (përfshirë cilindra pneumatikë) dhe jastëkë ajri, mbështetëse stabilizues, pjesë LPG, sisteme jo origjinale të karburantit dhe dëmtimi i tyre direkt dhe indirekt (që rezulton nga përshtatja e sistemit të karburantit në LPG, ose sisteme të tjera jo origjinale nga fabrika);
 - Kabina dhe boja, pjesë të tilla, si dritat, llambat, parakolpët, xhamat, elementë inoksi, doreza, antena, veshja e jashtme, pjesë metalike të lëmuara (pjesë metalike të pa veshura), boja, çdo korrozion i shkaktuar nga riparimi i papërshtatshëm, garancia e përgjithshme e korrozionit mbetet në fuqi;
 - Brendësia (p.sh tapiceria e sediljes, shtresat e këmbëve, shpërndarësit e ajrit, tavllë, ndezësi i cigares, koka e levës së marshit, mbulesa dhe zbukurimi i panelit, timoni.);
 - Sistemet multimediale;
 - Pjesë që nuk janë pjesë origjinale Toyota, pajisje që nuk janë pajisje origjinale Toyota dhe pajisje speciale;
 - Aksesorë origjinalë Toyota që nuk janë instaluar në fabrikë. Aksesorët origjinal Toyota që janë instaluar lokalisht dhe nuk pasqyrohen në skedarin e makinës brenda tre muajve nga regjistrimi i saj i parë;
 - Pjesë dhe përbërës individualë, p.sh. sistemi i shkarkimit (të gjitha pjesët nga guarnicionet e kolektorit të thithjes, deri në dalje, duke përfshirë katalitikun); veshja e tavanit; mentesha; dado dhe bulona; siguresat; rripat dhe tensionuesit; stabilizatorë para dhe mbrapa; këmbët e motorit dhe kabinës; ngrohës i karburantit; kabllot e karikimit EV dhe Plug-in;
 - Të gjitha pjesët jashtë trupit të automjetit (përveç, pjesëve të përmendura qartë në pikën 2 më lart);
 - Riparimet për heqjen e zhurmës (nëse kjo nuk është pasojë e dëmtimit të një pjese të mbuluar nga ky program);
 - Vendosjet dhe preferencat
 - Pasojat e ndërhyrjes së një pale të tretë që vepron si prodhues, ose furnizues, sipas një kontrate riparimi, ose garancie. Kjo gjithashtu përfshin fushata të përditësimit dhe fushata garancie të organizuara nga ai prodhues;

- pjesët të cilat janë modifikuar, përveç nëse modifikimi është në përputhje me një procedurë të deklaruar nga prodhuesi;
- pjesët e sistemit të karburantit: ndërrimi, ose pastrimi i linjave të karburantit, filtrave, shpërndarësve dhe pompave, si rezultat i përdorimit të karburantit që përmban papastërti;
- heqja e mbetjeve të djegies dhe dëmtimi, që rezulton nga to (përfshirë ndonjë valvul të djegur);
- programimi;
- keqfunksionimet e mëparshme, zgjidhja dhe riparimi i të cilave nuk kanë përfunduar, nuk do të mbulohen.

Përveç sa më sipër: Pjesët dhe përbërësit që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me mungesën e mirëmbajtjes periodike në përputhje me rekomandimet e prodhuesit, përfshirë: frekuencën e zëvendësimit dhe përdorimin e pjesëve origjinale.

4.Kërkesa që të jetë në fuqi Garancia e zgjatur Toyota Relax

Garancia e zgjatur Toyota Relax do të hyjë në fuqi vetëm nëse pronari i automjetit ka një faturë që vërteton se automjeti i tij i është nënshtruar shërbimit periodik në Servisin tuaj të autorizuar Toyota në territorin e Republikës së Shqipërisë, Republikës së Bullgarisë dhe Republikës së Maqedonisë Veriore, në përputhje me kushtet e përshkruara në këtë dokument dhe me kusht që automjeti të jetë përdorur në përputhje me rekomandimet e përfshira në manualin e përdorimit.

Aparatura e kroskotit të makinës nuk duhet të ndryshohet, ose të ndërhyhet. Në rast dëmtimi, shkoni menjëherë në Servisin më të afërt të Autorizuar Toyota në territorin e Republikës së Shqipërisë, Republikës së Bullgarisë dhe Republikës së Maqedonisë Veriore, duke treguar kilometrazhin aktual të automjetit. Çdo ndërhyrje, ndryshim i leximit, ose zëvendësim i kilometrazhit të makinës, mund të zhvlerësojë garancinë.

Pjesët rezervë dhe materialet e konsumit të përdorura për mirëmbajtje dhe riparime gjatë Garancisë së Zgjatur Toyota Relax duhet të jenë ekskluzivisht pjesë origjinale dhe materiale konsumuese Toyota. Përfitimet e zgjatjes së garancisë nuk do të zbatohen për Toyota, në rast se një keqfunksionim, ose anomali, rezulton nga një operacion i kryer jashtë rrjetit të Shërbimit Toyota.

5.Përdorimi i Toyota Relax

Nëse një defekt mbulohet nga Garancia e Zgjatur Toyota Relax, automjeti duhet të dërgohet menjëherë në stacionin më të afërt të shërbimit në rrjetin e aprovuar nga Toyota, brenda një maksimumi prej shtatëdhjetë e dy orësh (72) të defektit.

Ju do të duhet të siguroni informacionin e nevojshëm për të diagnostikuar dëmin dhe të merrni të gjitha masat e mundshme parandaluese për të minimizuar dëmtimin e mëtejshëm të automjetit.

6.Vendimi për të aplikuar Garancinë e Zgjatur Toyota Relax

Nëse konsumatori nuk i plotëson kushtet e përshkruara në këtë dokument, ose në rast neglizhence nga ana e tij, mbulimi i Garancisë së Zgjatur bëhet i paefektshëm.

Në mënyrë të ngjashme, zgjatja e garancisë do të anulohet, nëse Automjeti që i nënshtrohet kontratës, deklarohet i dëmtuar plotësisht dhe/ose është çregjistruar nga qarkullimi.

7.Përdorimi i Garancisë së Zgjatur Toyota Relax Jashtë Shqipërisë

Jashtë Shqipërisë, Garancia e zgjatur Toyota Relax është e vlefshme vetëm për një qëndrim, jo më shumë se 90 ditë rresht, në një nga vendet e renditura në zonën gjeografike të lart përmendur. Të gjitha riparimet dhe/ose zëvendësimet duhet të kryhen nga një Servis i autorizuar Toyota. Pronari i automjetit është i detyruar të paguajë kostot përkatëse, nëse riparimi nuk do të kryhet në Republikën e Shqipërisë, Republikën e Bullgarisë, ose Republikën e Maqedonisë Veriore, por në një nga shtetet që renditen në zonën gjeografike të lart përmendur. Pronari i automjetit, duhet të paraqitet pranë servisit të autorizuar në Republikën e Shqipërisë (aty ku ka marrë certifikatën e garancisë së zgjatur Toyota Relax) me faturën përkatëse të riparimit të kryer, brenda 30 ditëve nga data e lëshimit të faturës dhe menjëherë do t'i rimburohet vlera përkatëse në Lek..

8. Transferimi i Garancisë së Zgjatur Toyota Relax

Garancia e zgjatur Toyota Relax transferohet tek pronari i ri i makinës, për sa kohë që ai nuk ka tejkaluar numrin maksimal të kilometrave dhe periudhën e mbulimit.